



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTERI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Shkurt 2022

2

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



CEREMONIA HAPËSE E TIRANA- KRYEQYTETI EVROPIAN I RINISË, PASOHEM NGA PANAIRI I PUNËS SYN+ERGASIA

Në 4 shkurt 2022 u zhvillua ceremonia e hapjes së titullit "Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë", në ambientet e Pallatit të Kongreseve. Qindra të rinj, delegatë dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme u bënë bashkë për të festuar çeljen e siparit të qindra aktiviteteve që do të mbahen përgjatë Vitit të Rinisë.

Kjo veprimtari u pasua dhe me Panairin e Punës Syn+Ergasia, i cili u mbajt më 24-25 shkurt.

Panairi ishte një mundësi e mirë për të rinjtë që të takonin biznese dhe organizata që ofrojnë praktika pune, mundësi punësimi, këshillim karriere, si dhe trajnime për të përgatitur CV dhe letra motivimi.



FINALIZOHET KONKURSI "KUPA E BIZNESIT KRIJUES", I RIU FITUES DO TË PREZANTOJË IDENË E TIJ NË DANIMARKË

Në kuadër të projekteve fituese si pjesë e Thirrjes së Parë nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, Instituti Adriapol zhvilloi konkursin për Kupën e Biznesit Krijues, më 21 dhe 22

shkurt në qytetin e Shkodrës, me qëllim nxitjen e ideve novatore dhe sipërmarrëse mes të rinjve.

Gjatë këtij aktiviteti të rinjtë u trajnuan, mentoruan dhe mbështetën për të kthyer projekt-identë e tyre në plane të mirëfillta për krijimin e startup-eve të suksesshme. Ky aktivitet u finalizua me shpalljen e një fituesi, i cili do të marrë pjesë në një konkurs ndërkombëtar në Danimarkë për të prezantuar idenë e tij të biznesit krijues në fushën e marketingut.

MBLEDHJA E PARË E KËSHILLIT KOMBËTAR RINOR PËR 2022

Këshilli Kombëtar Rinor (KKR) u mblodh nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, më datë 2 shkurt 2022, me fokus konsultimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë.

Gjatë takimit u diskutua rëndësia e kontributit të vazhdueshëm këshillues të KKR-së përsa i përket realizimit të proceseve kyçe në fushën e rinisë, si projekti i Bashkimit Evropian për Garancinë Rinore, përgatitja e Thirrjes së VII për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës dhe ndërtimi i bazës së të dhënave për Rininë.

AKR NËNSHKRUAN MARRËVESHJEN E MIRËKUPITIMIT PËR PROJEKTIN RAYS PËR FUQIZIMIN E TË RINJVE

Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Palladium Group, nënshkruan marrëveshjen e mirëkuptimit, në mbështetje të projektit "Ndërlidhja midis Rinisë dhe Shoqërisë" (RAYS), më 17 shkurt 2022.

Projekti "RAYS" sjell në fokus mirëqenien dhe fuqizimin e të rinjve në Bashkinë e Elbasanit, Shkodrës dhe Kukësit. Kjo do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve që mbështesin punën në komunitet dhe angazhimin qytetar, vendim-marrjen lokale dhe ndërtimin e partneriteteve.



VIZITA E SEKRETARES AUSTRIAKE TË SHTETIT PËR RININË

Më 10 shkurt, u organizua një takim i parë midis Ministrit të Shtetit për Rininë me Sekretaren Austriake të Shtetit për Rininë, Znj. Claudia Plakolm me fokus përforcimin e bashkëpunimit mes dy shteteve në fushën e rinisë, duke konfirmuar sërish se "integrimi evropian vjen përmes angazhimit të të rinjve". Gjatë takimit Znj. Plakolm theksoi sërish se Shqipëria ka mbështetjen e Austrisë në procesin e integritimit në BE.

Pjesë e vizitës së sekretares së Shtetit ishte dhe takimi me sipërmarrësit e rinj shqiptarë të fushave të ndryshme, të cilët ndanë me ne sfidat dhe mundësitë e ofruara për biznes në Shqipëri.



ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I PROGRAMIT TË FËMIJËVE EKSTRA-KURRIKULAR

Përgjatë muajit shkurt, realizuam vizita në disa shkolla që janë pjesë e programit "Shkolla si Qendër Komunitare", për të kuptuar sesi eksperiencia e tyre mund të përdoret për zhvillimin e mëtejshëm të programit të ri ekstra-kurrikular të fëmijëve.

Në Shkollën e Mesme të Bashkuar "Gjovalin Gjadri" në Lezhë realizohej me sukses klasa e artit dhe e zejeve tradicionale, në shkollën "Ardian Klosi" në Tiranë, të rinjtë ishin bërë pjesë e klubit të teknologjisë dhe dizenjonin programe nga më të ndryshmet në mikro-kompjutera, ndërsa shkolla "E Re" në Kënetë të Durrësit ndër të tjera na njohu me modelin e Hapësirave Zhvillimore. Po ashtu, edhe në Qarkun e Elbasanit, u zhvillua panairi i shkollave si Qendër Komunitare, ku fëmijët prezantuan punën e tyre në arte, zeje, shkencë dhe teknologji.



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi